



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 qershor 2024
Nr. ref.: RK 2450/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI204/23

Parashtrues

Ibrahim Svarça

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. nr. 145/2022, të 5 majit 2023**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ibrahim Svarça, me banim në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës) i përfaqësuar nga Kushtrim Bytyqi avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 145/2022, i 5 majit 2023, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 26 maj 2023.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 shtator 2023, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 26 shtator 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [KSH.KI204/23] caktoi gjyqtarin Enver Peci gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzie Istrefi Peci, anëtarë.
7. Më 9 tetor 2023, Gjykata e informoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme.
8. Më 9 tetor 2023, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin [Rev.nr.145/2022] të 5 majit 2023 të Gjykatës Supreme.
9. Më 25 tetor 2023, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
10. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 29 prill 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës parashtron për herë të dytë kërkesë në Gjykatë. Më parë kishte parashtruar kërkesën KI32/16. Nëpërmjet kësaj kërkesë parashtruesi i kërkesës kontestoi aktgjykimin [Rev. nr. 221/2015] të 1 shtatorit 2015 të Gjykatës Supreme. Këtë kërkesë Gjykata e kishte shpallur të papranueshme.

13. Gjykata në mënyrë të përmbledhur do t'i reflektojë faktet e rastit KI32/16, për aq sa ato ndërlidhen me rastin e tanishëm.

Përmbledhja e fakteve lidhur me rastin KI32/16

14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Shoqërisë Aksionare "Montazha" nga Beogradi, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë në ngastrën kadastrale e cila është e evidentuar me numër 1504/2, në bazë të kontratës për shitblerje të 13 majit 2005.
15. Më 3 prill 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 841/2006), ka aprovuar kërkesën e parashtruesit.
16. Pas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar në Komunën e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (në tekstin e mëtejme: Komuna e Prishtinës), kërkesën për regjistrimin e pronës së paluajtshme.
17. Për shkak "të heshtjes së Administratës të Komunës së Prishtinës, lidhur me mosrealizimin e kërkesës për kryerjen e transaksionit", më 2 tetor 2007, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Ministrinë e Shërbimeve Publike, Agjencia Kadastrale e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Agjencia Kadastrale).
18. Më 8 tetor 2007, Agjencia Kadastrale nxjerr konkluzion (nr. 738/7) dhe "urdhëron Zyrën Kadastrale në Prishtinë që të shqyrtojë kërkesën për regjistrim të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe të nxjerr Vendim për këtë çështje administrative".
19. Për shkak të mosveprimit të mëtejshëm të Komunës së Prishtinës, në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Komunale në Prishtinë në procedurë përmbartimore ndaj debitorit, Komuna e Prishtinës, ku kërkoi regjistrimin e parcelës në emër të tij.
20. Më 8 shkurt 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi E. nr. 6/09), aprovoi kërkesën e parashtruesit. Më tej, në Aktvendim theksohet "[...] në bazë të dokumentit përmbartues-Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. Nr. 841/2006 i dt.03.04.2007 është i formës së prerë më 14.05.2007 [...]. **CAKTOHET PËRMBARTIMI ashtu që URDHËROHET debitori Komuna e Prishtinës-Drejtoria për pronë Gjeodezi dhe kadastër që të regjistroj në librat e tokës në emër të kreditorit Ibrahim Svarça nga Prishtina, paluajtshmërinë-ngastrën kadastrale nr. 1504/2**".
21. Më 18 mars 2011, Agjencia Kadastrale (Aktvendimi nr. 011952-2292) aprovon kërkesën e parashtruesit që ka të bëjë me të drejtën e shfrytëzimit të pronës.
22. Më 16 prill 2011, Komuna e Prishtinës i drejtohet Agjencisë Kadastrale nëpërmjet parashtrësës 001-031-218, duke u arsyetuar për moskzekutim të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale dhe duke pretenduar që në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 dhe Urdhëresës së UNMIK-ut 2006/17, Komuna kishte njoftuar Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme lidhur me rastin, duke argumentuar që çështja është dashur të gjykohej në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe jo në Gjykatën Komunale.
23. Më 16 maj 2011, Zyra Kadastrale e Komunës së Prishtinës, ka lëshuar Certifikatën mbi të drejtat pronësore në paluajtshmëri, me nr. UL-71914059-09836, në emër të parashtruesit të kërkesës.

24. Pasi parashtruesi i kërkesës kishte fituar të drejtat e plota në paluajtshmërinë në fjalë, ushtroi padi për kompensim të demit material në Gjykatën Komunale në Prishtinë ndaj Komunes së Prishtinës. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar *“që të detyrohet Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Prishtinë në emër të qerasë për pronën në ngastrën kadastrale 1504/2[...] t’ia kompenzojë për periudhën 14.05.2007 deri më 01.05.2010 shumën prej 469. 273.30 Euro si dhe për periudhën e ardhshme duke filluar prej 01.05.2010 e tutje [...]”*.
25. Më 20 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 2644/08), refuzoi kërkesëpadinë si të pabazuar.
26. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, C. nr. 2644/08, të 10 nëntorit 2011, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
27. Më 3 mars 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 4521/12), refuzoi si të pabazuar ankesën. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj arsyeton se gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim të drejtë dhe të bazuar.
28. Më pas, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, ndaj Aktgjykimit Ac. nr. 4521/12 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
29. Më 1 shtator 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi, Rev. nr. 221/2015), refuzon si të pabazuar kërkesën për revizion. Gjykata Supreme e Kosovës arsyeton *“[...] gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale”*.
30. Më 23 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit.
31. Më 3 dhjetor 2015, Prokurori i Shtetit, me njoftimin KMLC. nr. 123/2015, ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë me arsyetimin se *“ka kaluar afati ligjor për paraqitjen e këtij mjeti juridik”*.

Përmbledhja e fakteve për rastin e tanishëm KI204/23

32. Më 26 dhjetor 2008, parashtruesi i kërkesës, në Gjykatën Themelore kishte ushtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të cilën e kishte plotësuar me parashtresën e datës 21.03.2016, me kërkesë që të detyrohet e paditura për kompensimin e demit material, në emër të qeras dhe atë për periudhën kohore duke filluar nga data 14.03.2008 deri me date 07.03.2011, në shumën prej 328,121.00 euro, se bashku me kamate të llogaritur sipas arritjeve mujore të qirave për pagesë me normë prej 3.5% në vit, ku arrin shumën e përgjithshme, në shumën prej 389,949.07 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore nga dita e pranimit të aktgjykimit C.nr.842/2006 datë 14.03.2008, e deri në përmbarrim të dhunshëm të tij.
33. Më 18 maj 2016, Gjykata Themelore përmes aktgjykimit [Ca.nr.2644/2008] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.

34. Në një datë të paspecificuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes të dispozitave të ligjeve materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar ndërsa aktgjykimi i goditur ta prish dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
35. Më 22 tetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimin [Ac.nr.453/2017] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C.nr.2644/2008] të 18 majit 2016.
36. Në një datë të paspecificuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimin të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rivendosje apo që ky aktgjykim të ndryshohet dhe miratohet ankesa e paditësit si e bazuar duke u aprovuar kërkesëpadia e tij.
37. Më 5 maj 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimin [Rev.nr.145/2022] refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër aktgjykimin të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.453/2017] të 22 tetorit 2021.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, [Rev.nr.145/2022], të 5 majit 2023, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
39. Parashtruesi i kërkesës thekson se “ *Gjykata e Apelit, me vendimin e atakuar nuk ka dhënë arsytim të mjaftueshëm për faktet vendimtare në të cilat është mbështetur kërkesa, përkatësisht refuzimi i saj*”. Ai më tej thekson se “ *ka parashtruar kërkesë për regjistrimin e pronës, në bazë të aktgjykimin C.nr. 842/06, dt. 14.03.2008, të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Mirëpo kjo prone është regjistruar në emër të paditësit tek me datën 18.03.2011, në bazë të vendimit të gjykatës për përmbarim. Pra megjithëse kishte një aktgjykim të formës së prerë për vërtetimin e pronësisë, i njëjti nuk është përfillur, duke vlerësuar nga e paditura se ka një çështje paraprake (të paqenë) dhe këtë arsytim e pranojnë gjykata për lirim të paditurës nga fajësia / detyrimi për kompensimin e demit në emër të paditësit. Mirëpo Gjykata Supreme, dhe gjykatat me të ulta nuk kanë dhënë arsytim të mjaftueshëm për këtë qëndrim juridik*”.
40. Më tej parashtruesi i kërkesës thekson se “ *... konsiderojmë se në rrethanat e rastit konkret, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesën e arsytimit përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore konsistojnë në shkeljen e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht nenit 154 të LMD dhe nenit 9 të LPK, pasi gjykata është kompetente për vlerësimin e kompetencës lëndore për gjykimin e kontesteve pronësore, e jo organet e administratës. Për më tepër vërehet se Gjykata Supreme, është pajtuar dhe ka vetëuar vendimin e Gjykatës së Apelit, bazuar në të cilin theksohet, e paditura nuk mund të konsiderohet me faj për demin e paditësit sepse ka përfillur rregullativën ligjore, mirëpo nuk jepet arsytim shtesë për këtë qëndrim, si dhe nuk arsyetohet anashkalimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës nga e paditura*”.

41. Në fund parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: (i) të deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka shkelje të nenit 31 të kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.145/2022 të 5 majit 2023; (iv) të kthejë lëndën e rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Themelore.

Pranueshmëria e kërkesës

42. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

44. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.

45. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin

[Rev.nr.145/2022] e 5 majit 2023 të Gjykatës Supreme; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

46. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nën rregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.

47. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KIO4/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

48. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nën kriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GjEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNJ-së, [Kemache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituaniës](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).

49. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, vlerësimi nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [K104/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
50. Rrethanat e rastit konkret, rezultojnë nga padi e parashtruesit të kërkesës kundër Komunes së Prishtinës për kompensimin e demit material, ne emër të qeras dhe atë për periudhën kohore duke filluar nga data 14.03.2008 deri me date 07.03.2011, ne shumën prej 328,121.00 euro, se bashku me kamate të llogaritur sipas arritjeve mujore të qirave për pagesë me normë prej 3.5% ne vit, ku arrin shumen e përgjithshme, ne shumë prej 389,949.07 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore nga dita e pranimit të aktgjykimit C.nr.842/2006 datë 14.03.2008, e deri në përmbarim të dhunshëm të tij. Kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e pabazuar nga Gjykata Themelore. Kundër vendimit të Gjykatës Themelore parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila ankesë ishte refuzuar dhe ishte vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore. I pakënaqur me vendimin e Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar me revizion Gjykatës Supreme, ku kjo e fundit e kishte refuzuar si të pathemeltë revizionin e paraqitur nga ai.
51. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
52. Gjykata verën se esenca e pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, ndërlidhet me mos arsyetimin e vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës Supreme. Gjykata vlerëson se pretendimet e tilla ngrejnë çështje nga neni 31 i Kushtetues dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, të cilat Gjykata do t'i analizojë në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

(i) Sa i përket pretendimit për vendim të pa arsyetuar gjyqësor

53. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pranë Gjykatës, në esencë, thekson se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar se cilat kanë qenë faktet dhe provat të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit, pasi që “ ... konsiderojmë se në rrethanat e rastit konkret, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesën e arsyetimit përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore konsistojnë në shkeljen e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht nenit 154 të LMD dhe nenit 9 të LPK, pasi gjykata është kompetente për vlerësimin e kompetencës lëndore për gjykimin e kontesteve pronësore, e jo organet e administratës. Për më tepër vërehet se Gjykata Supreme, është pajtuar dhe ka vetëtuar vendimin e Gjykatës së Apelit, bazuar në të cilin theksohet, e paditura nuk mund të konsiderohet me faj për demin e paditësit sepse ka përfillur rregullativen

ligjore, mirëpo nuk jepet arsytim shtesë për këtë qëndrim, si dhe nuk arsyetohet anashkalimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës nga e paditura”.

54. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë nr.12945/87*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës nr.18064/91*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës nr.134/1996/753/952*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës nr.30544/96*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës nr.49684/99*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës nr.37801/97*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; dhe *Tatishvili kundër Ruisë nr.1509/02*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë por duke mos u kufizuar në *KI22/16*, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; *KI97/16*, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; *KI143/16*, parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; *KI87/18*, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019; si dhe rastin *KI230/19*, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
55. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës *KI230/19*, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin *KI87/18*, parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
56. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsytimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës *KI97/16*, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin *KI87/18 IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë nr.19867/12*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës *KI195/20*, parashtrues *Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar “Monego”*, Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafi 122).
57. Gjykata me këtë rast rikujton se Gjykata Themelore kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, ku përmes aktgjykimit [Ca.nr.2644/2008] të 18 majit 2016 ndër të tjera kishte theksuar:

“ Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në Prishtinë, me shkresën nr.0002166 datë 08.05.2009, i është përgjigjur kërkesës se paditësit ne te cilën është theksuar se Ibrahim Sfarqa (paditës), është këshilluar nga ish AKM, se për këtë çështje ti drejtohet Dhomës së Posaçme te Gjykatës Supreme te Kosovës, mirëpo paditësi e ka anashkaluar një gjë te tillë dhe çështjen ka vendosur paditësi ta zgjedh ne Gjykatën Komunale ne Prishtine, e cila sipas nenit 4.1 te Rregullës 2008/4 te UNMIK-ut, nuk ka juridiksion për te vendosur për këtë çështje kontestimore. Në shkresën e AKP-se drejtuar paditësi me tej theksohet se kontrata e lidhura mes paditësit dhe ndërmarrjeve qe veprojnë jashtë territorit te Republikës se Kosovës janë jo legjitime, do të konsiderohen si nule dhe pa efekt juridik – kontrata e lidhur te kësaj natyre duke anashkaluar Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nuk janë legjitime, për arsytet e mungesës së juridiksionit të dhënë kësaj Gjykate me Rregulloren 2008/04, dhe me urdhëresën administrative për ndryshimin dhe plotësimin e urdhëresës 2006/07, për zbatimin e rregullores së UNMIK-ut 2002/12. Gjithashtu paditësi është këshilluar, shume here qe ti drejtohet gjykatës kompetente për ndryshimin e titullarit për paluajtshmerinë konkrete ku kompetenca sipas rregulloreve te lart theksuara i bie Dhomës se Posaçme pranë Gjykatës Supreme te Kosovës. E paditura mbështetur në provat e saj ka gjetur se nga te dhënat kadastrale prona kontestuese është e evidentuar si prone shoqërore e cila është detyruar te kërkoj pëlqimin nga Agjencioni, qe administron me këto lloj paluajtshmerie duke mos ekzekutuar aktgjykimin e formës se prere te Gjykate Kor.1unale ne Prishtine i konsideruar nga AKP-ja si vendim i nxjerr nga një gjykate jo kompetente, sipas rregulloreve te UNMIK-ut te lart theksuara. E paditura gjithashtu për ta bere edhe me bindëse mos fajësinë e saj vërtetohet edhe nga raporti i veçante i Policisë se Kosovës drejtuar Prokurorisë publike te Qarkut ne Prishtine nr. Ref. PPN.nr.750-2/08 dt. 11.11.2008, i cili len te nënkuptoj se nuk është ngritur kallëzim eventual penal ndaj zyrtareve te Komunës se Prishtinës për mos regjistrim te paluajtshmerise ne emër te paditësit. Për me tepër, gjykata ka ardhur ne përfundim se korrespondencat e shpeshta mes paditësit ish AKM, AKP-se, dhe institucioneve tjera, ka bere qe për shume here e paditura ta rikonfirmon arsyen e mos regjistrimit te paluajtshmerise kontestuese ne emër te paditësit, siç shihet nga shkresat e lendes. Andaj ne asnjërin veprim të paditëses gjykata nuk gjeti faj si pasojë e së cilës është dëmtuar paditësi apo është ngadalësuar procesi i regjistrimit te paluajtshmerise kontestuese ne emër te paditësit”.

58. Gjykata e Apelit, duke shpallur si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, kishte vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore [Ca.nr.2644/2008] të 18 majit 2016, ku ndër të tjera kishte theksuar si në vijim:

“Njëherit gjykata e shkalles së parë ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike nga administrimi dhe vlerësimi i provave, dhe 190 gjykate konsideron se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për faktin se nga shkresat e lendes rrjedh se e paditura nuk është përgjegjëse për kompensimin e demit te pretenduar nga paditësi, për faktin relevant se e paditura ne përpjekje te zbatimit te aktgjykimit te sipër përmendur përkatësisht ndryshimit dhe bartjes se paluajtshmerise me paditësin, e nga arsytet e sipër cekura, po thuhet suksesivisht kërkonte ne kuadër te kompetencave te veta ligjore mendimin përkatësisht pëlqimin përkatës nga AKM-ja e cila aktgjykimin e sipër përmendur e konsideronte si një vendim i nxjerr nga një gjykate jo kompetente, pra duke konsideruar se për çështjen e pronës kontestuese do te duhej te vendoste Dhoma e Posaçme te Gjykatës Supreme e Kosovës, e jo ndonjë gjykate tjetër vendore qe nuk ka juridiksion. Me fjale të tjera përgjegjësia për dëmin eventual të kërkuar

nga paditësi nuk mund ti mvishet veprimi a mos veprimi të Komunës - të paditurës, sepse në këtë mes kishte ndërhyrë AKM-ja, me qëndrime të saja të sipër shtruar dhe se e paditura siç rezulton nga shkresat e lëndës ishte në kërkim e sipër të pëlqimit përkatës nga AKM-ja. Në llogari të këtij fakti fiasin edhe shkresat e lëndës, respektivisht korrespondenca në relacionin midis të paditurës AKM dhe paditësit. Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret e paditura nuk ka shkaktuar asnjë lloji dëmi me përfilljen e rregullave ligjore në fuqi, të cilat kanë rregulluar fushe veprimin e saj me rastin e bartjes dhe evidentimit të ndryshimeve të pronareve eventual të patundshmërisë.. “[...]”

59. Më tej, Gjykata Supreme në Aktgjykimin [Rev.nr.145/2022] të 5 majit 2023, ndër të tjera theksoi:

“... Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë arsytimit të plotë dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, meqë gjykatat e instancës më të ulët drejte kanë zbatuar të drejtën materiale dhe atë dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e detyrimeve. Kështu, edhe kjo Gjykatë, konsideron se në rastin konkret juridiko-civil, nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative të gjitha parakushtet e përgjegjësive për kompensimin e dëmit të parapara me dispozita e nenit 154 etj, të LMO-se, e siç janë; ekzistimi i subjekteve të marrëdhënies detyrimore dhe të përgjegjësive për dëmin e shkaktuar, pra shkaktuesin e dëmit dhe të dëmtuarin, ekzistimi i faktit dëmtues, nga rezulton dëmi, ekzistimi i dëmit të shkaktuar, ekzistimi i lidhjes shkakësore nëpërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar si dhe të ekzistojë kundërligjshmëria e veprimit, përkatësisht, e mosveprimit, gjë që, sikundër u theksua me lartë këto parakushte nuk janë provuar se ekzistuar nga pala paditëse”.

60. Gjykata vëren se fillimisht Gjykata Themelore dhe më pas edhe Gjykata e Apelit edhe Gjykata Supreme, kishin konstatuar se me provat e prezantuara nga parashtruesi i kërkesës dhe të administruara nga gjykata nuk janë vërtetuar bindshëm faktet përkitazi me bazueshmërinë e kërkesëpadisë që kanë të bëjnë me ekzistimin e dëmit të kërkuar si dhe përgjegjësinë e së paditurës për kompensimin e atij dëmi.
61. Gjykata me këtë rast, rikujton se nisur nga praktika e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, e njëjta nuk kërkon përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar.
62. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për pasojë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes” ashtu siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.
63. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 29 prill 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues


Enver Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani